



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

632-25-2180-2-2-1/C1103

KOMUNA E GJAKOVËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.; D D D SH.P.K., Taslixhe II, PRISHTINË, me numër unik 811498957 & 811319955 e përfaqësuar nga Lulëzim Katanolli(ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi me numër identifikues: **632-25-2180-2-2-1** dhe numër të brendshëm **632-25-030-221**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi

| Nr. | Grupi |
|-----|--------------------------------------------------|
| 1 | Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi |

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofriuesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 11.07.2025 dhe përfundon në datën 10.07.2026.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **12 muaj**. Kryerja e shërbimeve do të bëhet sipas kërkesës së Menaxherit të kontratës.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë **në Komunën e Gjakovës**.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është **43,335.00€**(katërdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e pesë euro).

Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është 30% +/-.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fiksë dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specififikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvëç njëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe në tri originale, dy originale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

| | |
|--------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|
| Emri: | Faton Gutaj |
| Pozita: | Zyrtar përgjegjës i prokurimit |
| Nënshkrimi: |  |
| Data: | 11.07.2025 |
| Vula: | |



Për Ofruesin e Shërbimeve

| | |
|--------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri: | Lulëzim Katanolli |
| Pozita: | Drejtor Menaxhues |
| Nënshkrimi: |  |
| Data: | 11.07.2025 |
| Vula: | |



KUSHTET E PËRGJITHSHME

632-25-2180-2-2-1/C1103

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofritesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Shërbimet**" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofritesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofritesit të Shërbimeve.

1.3 "**Ofrites i shërbimeve**" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "**Personeli**" do të thotë personat e angazhuar nga Ofritesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "**Çmimi i kontratës**" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "**Nënkontraktuesi**" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofritesi i Shërbimeve.

1.7 "**Palë**" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofriten i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "**Palë**" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "**Autoriteti Kontraktues**" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohej në Kontratë.

1.9 "**KPK**" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "**KVK**" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuba dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofriten i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofritesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofritesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofritesit të Shërbimeve siguruesve të Ofritesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjeter i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofritesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofriten i

Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përpunje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritur të tatimeve dhe detyrimet doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimet doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

- dëshimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshtë ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në

mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 **Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënien të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përvèç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqë jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime registrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e këruar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të këruar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjedhur në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbrushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grüpuit nuk do të ndryshohet pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësiteti në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zgresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërsi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;

- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofrcuesi i Sherbiueve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofrcuesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofrcuesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofrcuesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofrcuesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofrcuesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofrcuesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofrcuesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofrcuesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofrcuesi i sherbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofrcuesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofrcuesi i Shërbimit

15.1 Ofrcuesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofrcuesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofrcuesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofrcuesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofrcuesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbytjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofrcuesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofrcuesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofrcuesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofrcuesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofrcuesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofrcuesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofrcuesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofrcuesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofrcuesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofrcuesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigjimit të defektit, ofrcuesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala c dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensi me:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërbime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkесës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkесës. Periudha maksimale që jetet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërbimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbilej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkakuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA
632-25-2180-2-2-1/C1103

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---------------------------------------------------|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit | Nr. Nenit | |
| Ligi i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| Obligimet Autoritetit Kontraktues | 12.3 | Menaxheri i Projektit është do të caktohet me vendim të ZKA. |
| Siguria e ekzekutimit | 14.1 | Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës me vlefshm prej 13 muaj. Kontraktuesi obligohet qe para nënshkrimit të kontratës të bëj depozitim i sigurisë së ekzekutimit. |
| Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit | 15.1 | Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar |
| Kualiteti i Kontrollit | 17.1 | Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: -Inspektimi i shërbimeve kryhet nga Menaxheri i projektit i caktuar nga Komuna. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes | 20.2 | Komisioni per ndermjësim pranë Ministrise se Drejtësise |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 21.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë |

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme te objektit te kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe te operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar te vendos specifikime teknike qe favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shume operatorë ekonomik.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Preparatet te cilat do ti përdornin për Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim (DDD)

Lista e Sigurisë së preparateve që përdoren për DDD dhe lista me emra gjenerik dhe komercial të preparateve (prparatete me leje për importim dhe përdorim të produkteve biocide të notifikuara me qertifikata të analizave dhe ndonjë dokument mbi origjinën e produkteve biocide)

Dezinsektimi.(Asgjësimi i insekteve fluturuese dhe zvaritëse).

Gjatë këtij procesi,të përdoren preparate te cilat kanë veprim eliminues dhe kontrollues te problemit me insekte fluturuese **Permethyl dhe piperonyl bytoxide 30 -30 %** ose ekuvalente

Gjatë këtij procesi,të përdoren preparate te cilat kanë veprim eliminues dhe kontrollues te problemit me insekte zvaritëse siq janë **Dinotefuran 40%** ose ekuivalent

Deratizimi (asgjësimi i brejtësve).

Duke e ditur kohen e shumimit te brejtësve deratizimi duhet te kryhet një herë në vit me kontrollë të vazhdueshme. Produktet që përdoren duhen te jenë me inhibitorë bio-statistik që pengon rritjen e këpurdhave dhe baktereve nëse blloku ekspozohet ndaj kushteve të lagështisë dhe të vendosen ne shtëpiza me qellim te ruajtjes te freskisë te produktit si dhe mos kontaminimin e ambientit.

Karremet te cilat do te përdoren gjatë procesit te deratizimit duhet te janë antikaugulant te gjeneratës së dyte (**Bromadiolone 0.005% dhe Brodifoucum 0.005%**)ose ekuivalente

Duhet te ceket Antidot:

Secila shtëpizë duhet te përbaj informatat: KUJDES HELM, Antidotin K1,Nr.e telefonit etj.

Dezinfektimi:me substancat aktive në vijim: komponimet kuantitative të ammoniumit dhe hipoklorit natriumi

DEZINSEKTIMI HAPSINOR I KK GJAKOVES

HYRJE

Edhe në Komunën e Gjakoves sikur në pjesën më të madhe të Kosovës në vazhdimësi prej viti në vit paraqiten sëmundje të ndryshme ngjitése si: tularemia, ethet hemoragjike, ethet e Nilit Perëndimor, sëmundja e LYME-it dhe një numër i madh i sëmundjeve tjera ngjitése të traktit digestiv dhe atij respirator. Një nga rrugët e përhapjes së këtyre sëmundjeve është edhe ajo e cila realizohet përmes vektorëve të cilët mund të jenë të ndryshëm: brejtës, insekte trëshqitëse dhe insekte fluturuese si: mizat, mushkonjat etj.

Me qëllim të parandalimit të sëmundjeve që mund të shkaktojnë dëmtim të shëndetit të popullatës, KK Gjakova ka paraparë aktivitete të ndryshme nga lëmi i shëndetit publik e një ndër to është edhe zbatimi sistematik i veprimeve të dezinsektimit hapsinor me qëllim të eliminimit apo sjelljes në kufijë të tolerancës epidemiologjike të insekteve fluturuese mbi teritorin e komunës tonë.

Përmes këtij projekti synohet parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitése përmes vektorëve dhe përmirësimi i kualitetit të jetës për qytetaret e komunës sonë. Masat për eliminimin e mushkonjave sipas OBSH-së duhet të përfshijnë tretmanin me larvicid residual dhe spërkatjen hapësinore. Principi themelor i spërkatjes së suksesshme hapsinore është arrija e kontaktit maksimal në mes të insekitit dhe insekticidit. Kjo më së miri arrihet nëse retë e aerosolit kanë madhësi optimale të grimcave (mjaft insekticid) dhe nëse kanë efikasitet të duhur sulmues. Për aksion efikas duhet të plotësohen disa kushte si: kushtet mikrometeorologjike, aplikimi i standardeve të parapara në kontekst të preparatit dhe metodës së aplikimit dhe karakteristikat e insekteve. Pastaj shumë me rëndësi është edhe përcaktimi i gjendjes reale i cili nënkupton identifikimin e insekteve që janë qëllim i eliminimit, përcaktimi i lokalitetit dhe vatrave, planifikimi i trajtimit, përcjellja e kushteve mikrometeorologjike, përgjedhja e insekticidit, mënyra e trajtimit, monitorimi i zbatimit dhe përcaktimi i efikasitetit të veprimeve. Trajtimi kryesisht do të përqendrohet në eliminimin e mizave, mushkonjave dhe larvave te tyre andaj e shofim të nevojshme që të përmendim disa nga sëmundjet që përhapin këto dy grupe insektesh. Mizat janë vektor potencial për sëmundjet si: intoksikacionet alimentare, toxoinfekcionet alimentare, sallmonelozat, dizenteria, gastroenteritet, tyfoide, kolera dhe tuberkulozi. Mushkonjat jetojnë prej 10 ditë deri 6 muaj, janë rrëth 3.000 lloje, mund të transmetojnë sëmundje në njerëz dhe në kafshë si : malaria, filiriaza, ethet e verdha, ethet dengue, ethet e Nilit Perëndimor, Chikungujën encefalitet si dhe shkaktojnë ndjenjë të pakëndshme dhe reaksione alergjike në rast të pickimi te njeriu.

QËLLIMI

Me këtë projekt synohet që të arrihen këto qëllime:

- Eliminimi ose sjellja në kufijtë të tolerancës epidemiologjike të insekteve fluturuese: mushkonjat dhe mizat
- Parandalimi dhe pengimi i përhapjes së sëmundjeve transmisiive që barten përmes insekteve që shërbejnë si vektorë.
- Eliminimi edhe i shumë shakatareve tjerë të dëmtimit të popullacionit bimor.
- Krijimi i kushteve për jetë më të qetë të qytetarëve.

AKTIVITET

Dezinsektimi hapësinor duhet te bëhet ne përputhje me legjisacionin në fuqi për shëndetin publik dhe ligjin për mbrojtjen e mjedisit. Duhet përdorur metodat më bashkëkohore me mjete të sofistikuara me aplikim nga toka. Gjithnjë duke u bazuar në rekomandimet e OBSH dhe CDC (Centre for Disease Control) (Qendra për kontrollin e Sëmundjeve) trajtimi duhet të fillojë në fund te muajit Qershor, varësisht nga kushtet klimatike (atmosferike) dhe do të kryhet në kater faza*.

***(Vërejtje – Faza shtesë do të realizohen nëse ekspertët pranë QKMF-së, Menaxherët e Kontratës dhe Drejtoria për Shëndetësi e konsideronë të nevojshme duke u bazuar në kushtet klimatike dhe popullacionin e insekteve gjatë periudhës kur kryhet ky proces)**

Projekti është paraparë të kryhet në katër faza* gjatë një viti.

Do të trajtohet e tërë sipërfaqja e Gjakovës me të gjitha lagjet, para-lagjet dhe zonat e Gjakovës te tjera.

Sipërfaqja që do të trajtohet parashihet të jetë rreth 1000 hektarë ku tretmani duhet te kryhet brenda 2 dite.

Kujdes i veçantë do ti kushtohet vendeve të përshtatshme për shumim, ushqim dhe pushim të insekteve e ato janë: sipërfaqet e gjelbërtë, Sipërfaqet me bimësi të dendur (zona malore,parqe rekreative),lumenjë, përrrockat, depot e mbeturinave dhe vendet me dendësi të madhe të popullatës. Do të synohet që insektet të goditen në fazën e tyre më aktive e që për mushkonja është fillimi i muzgut dhe orët e vona të mbrëmjes, kurse trajtimi për miza bëhet njëkohësisht gjatë trajtimit të mushkonjave. Qe të zvoglohet popullata e mizave preferohet të trajtohen më shpesh kontejnerët e mbeturinave dhe deponitë e egra të mbeturinave. KK Gjakova do te siguroj hartën e qytetit në të cilën janë te shënuara sipërfaqet e gjelbërtë, përrrockat, kolektorët e kanalizimit, deponitë e mbeturinave, tregjet me shumicë si dhe ndërtesa e larta. KK Gjakova do te jete ne kontakt te vazhdueshëm me MMPh-Institutin hidrometeorologjik me qëllim të përcjelljes së kushteve mikrometeorologjike dhe drejtimin e fryerjes së erërave.

Do të përdoren Larvicidet dhe Insekticidet. Larvicidet do të përdoren disa lloje të tyre varëshisht nga vendi i aplikimit,koha,konfiguracioni i terenit dhe në bazë të këtyre faktorëve do të përzgjidhet larviciidi më i përshtshem me efekt te zgjatur 30 ditorë. Larvicide bacillus thuringiensis israelensis, Ose ekivalente

Në përgjedhjen e insekticidit është bërë bazuar në rekomandime e OSH-së për tretman me insekticid ekologjik i aprovuar nga EPA ose Organizatat tjera ndërkombëtare i cili tretet lehtë me ujë, është efikas me sasi të vogël të materies aktive, me shkallë të lartë të sigurisë për njerëz, kafshë dhe ambient, të jetë fotostabil, termostabil, pa fitotoksicit, pa aroma, pa ngjyrë, pa shije dhe me veti biodegradabile. Pastaj, faktor tjetër i cili përcakton llojin e insekticidit është edhe tretmani ULV me mjegullim të ftohtë dhe tretje me ujë i cili bëhet me insekticid që janë të përzier me komponente të posaqme që mundësojnë krijimin e aerosolit dhe mjegullës aktive. Preparati ne perberjen e tij duhet të ketë substancë me veprim të zgjatur të veprimit. Ne preferojmë materie aktive **Permethrine 30%- Piperonyl butoxide 30%** Ose ekuivalente. Doza e materies aktive duhet të jetë qartë e përcaktuar në specifikimet e produktit dhe në përputhje me rekomandimet nga OSH-ja, EPA dhe organizatat tjera ndërkombëtare dhe legjislacioni i BE-së.

Aparatura e cila do të pëdoret për këtë aktivitet duhet të jete e përshtatshme duke pasur pasasysh ndjeshmerinë e aktiviteteve që ndërmiren e që njëherit duhet ruajtur ekuilibrat biologjik-ekologjik si dhe mbrojtjen e ambientit dhe shëndetit publik. Gjithashtu për tjetimin e vendeve me dendësi të lartë bimësie ku nuk mund të deportojnë gjeneratorët ULV me kamioneta do të përdoren paisje adekuate për qasje në ato lokacione e të cilat janë specifisht dë destinuara për këto aktivitete, ato duhet të janë të fuqishme dhe me psesion te ulët veprimi me rezervuar të solucionit të përshtatshem, gypa të gjatë deri në 100 metra me koka shtytëse të specifikuara për dezinsektim në menyrë që të depërtohet sa më thellë në zonat e dendura me bimësi, parqe rekaretive e të ngjajshme. Me këtë metodë synohet të arrihet efikasitet edhe më i lartë i zvoglimit të popullacionit të insekteve (mushkonjave, mizave).

Pompat motorrike LV të krahut do të perdoren për dezinsektimin e hapsirave urbane ku makineritë e mëdha nuk mund të kenë qasje të hynë në ato zona për dezinsektimin e rrugicave, hapsirave urbane me bimë, konteinereve të mbeturinave dhe deponive të egra që gjindën në KK Gjakoves, etj.

Për të gjitha këto aktivitete personeli profesional i këtij shërbimi duhet të ketë të gjitha masat mbrojtëse sipas rregullave për përdorimin e insekticideve apo materieve tjera kimike, si dhe udheheqësit e grupeve duhet të janë të trajnuar për përdorimin e preparateve biocide dhe paisjeve.

Në bazë të gjitha këtyre rekomandimeve dhe përparësive që u cekën më lartë, rrjedh se duhet të përdoren preparatet e testuara në aspektin toksikologjik dhe ekologjik, që gjenden në listën e preparatave të lejuara në listën e BE-së, EPA dhe të rekomanduara nga ana e OSH-së. Përbërësit e këtyre substancave duhet të janë me toksicitet sa më të ulët. Preparatet duhet të janë të dedikuara për trajtim nga toka, zbërthimi i substancës në raport me ujin të bëhet sipas udhëzimit të prodhuesit dhe sipas dozimit të përcaktuar dhe atëherë të përdoret përzierja sipas sasisë të paraparë për sipërfaqe (1 hektar).

BASHKËPUNIMI

Me qëllim të koordinimit të punëve rreth konkretizimit të projektit dhe duke patur parasysh se është veprim me efekt të përgjithshëm, ne do të bashkëpunojmë me Ministrinë e Shëndetësisë, IKSHP-në, MMPH, Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës me qëllim të sigurimit të

informatave të nevojshme, me shoqatën e bletarëve, me mjete të informimit publik si dhe me qytetarë.

Menaxhimi dhe raportimi

Në kuadër të KK Gjakoves do të caktohet Komisioni Mbikëqyrës për realizimin e këtij projekti i cili do të udhëzojë dhe përcjellë me përpikëri zbatimin e teknikave standarde gjatë realizimit të projektit. Plani i aktiviteteve do të jetë elastik me mundësi të plotësimit dhe ndërrimit eventual në rast të paraqitjes së nevojave të reja apo ndërrimit të mënyrës së trajtimit.


Komisioni mbikëqyrës për implementimin e projektit do të mbikëqyre vazhdimisht kryerjen e punëve në çdo fazë dhe në mënyrë sistematike do ti raportojë me shkrim .

Komuna e Gjakovës në bashkëpunim me Operatorin Ekonomik, nëpërmjet mjeteve të informimit shtypura, elektronike dhe rrjeteve sociale, radio dhe TV, do të njoftoj popullatën për kohën e veprimeve dezinsektuese me qëllim të marrjes së masave mbrojtëse për njerëzit, kafshët, e sidomos për bletët. Gjatë këtyre informatave duhet të theksohet: hapësira dhe koha e paraparë për dezinsektim.

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është +/- 30%.

| Nr. | Përshkrimi | Njësia Matëse | Sasia | Çmimi njësi me TVSH | Çmimi total me TVSH |
|--------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|-------|------------------------|------------------------|
| Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi | | | | | |
| 1 | Dezinsektimi i mushkonjave nga toka Dezinfektimi me njëren nga substancat aktive në vijim: - komponimet kuantitative të ammoniumit dhe hipoklorit natriumi | ha | 3100 | 6.00 | 18600.00 |
| 2 | DDD e hapësirës së myllur (QKMF,Objektet parashkollore dhe obejktet tjera Komunale) Dezinsektimi (Asgjësimi i insekteve). Gjatë këtij procesi,të përdoren preparate te cilat kanë veprim eliminues dhe kontrollues te problemit me insekte fluturuese. Dezinfektimi me njëren nga substancat aktive në vijim: - komponimet kuantitative të ammoniumit dhe hipoklorit natriumi Deratizimi bëhet me substancën aktive: Duke e ditur kohen e shumimit te brejtësve deratizimi duhet te kryhet një herë në vit me kontrollë të vazhdueshme .Produktet që përdoren duhet te vendosen në shtëpiza me qellim te ruajtjes te freskisë te produktit si dhe mos kontaminimin e ambienitit .Karremet te cilat do te përdoren gjatë procesit te deratizimit duhet te jen antikaugulant te gjneratë së dytë.Duhet te ceket Antidot: Secila shtëpizë duhet te përbaj informatat:KUJDES HELM,Antidotin K1,Nr.e telefonit etj. | m ² | 3300 | 0.45 | 1485.00 |
| 3 | Deratizimi i sistemit të kanalizimit - pusetave Deratizimi bëhet me substancën aktive: Duke e ditur kohen e shumimit te brejtësve deratizimi duhet te kryhet një herë në vit me kontrollë të vazhdueshme .Produktet që përdoren duhet te vendosen në shtëpiza me qellim te ruajtjes te freskisë te produktit si dhe mos kontaminimin e ambienitit .Karremet te cilat do te përdoren gjatë procesit te deratizimit duhet te jen antikaugulant te gjneratë së dytë.Duhet te ceket Antidot: Secila shtëpizë duhet te përbaj informatat:KUJDES HELM,Antidotin K1,Nr.e telefonit etj. | copë | 5000 | 4.50 | 22500.00 |
| 4 | Deratizimi i Podrumeve dhe garazheve të qytetit Deratizimi bëhet me substancën aktive: Duke e ditur kohen e shumimit te brejtësve deratizimi duhet te kryhet një herë në vit me kontrollë të vazhdueshme .Produktet që përdoren duhet te vendosen në shtëpiza me qellim te ruajtjes te freskisë te produktit si dhe mos kontaminimin e ambienitit .Karremet te cilat do te përdoren gjatë procesit te deratizimit duhet te jen antikaugulant te gjneratë së dytë.Duhet te ceket Antidot: Secila shtëpizë duhet te përbaj informatat:KUJDES HELM,Antidotin K1,Nr.e telefonit etj. | m ² | 3000 | 0.25 | 750.00 |
| Gjithsej totali me TVSH | | | | | 43335.00 |

KOMISIONI I VLERËSIMIT:

1. SH.H. - 

2. D.L. - 

3. P.F. - 

POLICA E SIGURIMIT TË GARANCISË
GUARANTEE INSURANCE CERTIFICATE

Nr.policës
Policy No

248/25

| | | | |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| I SIGURUARI DEBITORI KRYESOR | DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K. | SPECIALISTI/AGJENTI | SHQIPE BREZNICA |
| NUMRI I BIZNESIT | 811498957 | KODI I SPECIALISTIT AGJENTIT | 707 |
| NUMRI FISKAL | | DREJTORIA/FILIALI AGJENTIT | PRISHTINË |
| ADRESA | Prishlinë, 10000, Mehmet Akif Ersoy, Nr.17 Tashixhe, II | NUMRI I BIZNESIT SIGURUESI | 811296054 |
| PËRFAQËSUESI DEBITORI SOLIDAR | LULZIM KATANOLLI | NUMRI FISKAL SIGURUESI | 811296054 |
| NUMRI PERSONAL IDENTIFIKUES | 1019465027 | ADRESA E DREJTORISË SIGURUESI | Rr. "2 Korriku", nr. 4, Prishtinë, 10000 |
| SIGURIMI/GARANCIA FILLON MË: | 10.07.2025 | PRIMI I SIGURIMIT | 84.49 € |
| SIGURIMI/GARANCIA PËRFUNDON MË: | 09.08.2026 | TATIMI I VLERËS 18% SË SHTUAR | 15.21 € |
| SHUMA E SIGUARUAR | 4,333.00 | € SHUMA PËR PAGESË | 99.70 € |
| DATA E LËSHIMIT TË POLICËS | 10.07.2025 | DATA E PAGESËS | 10.07.2025 |
| PËRFITUES/AUTORITETI KONTRAKTUES | KOMUNA E GJAKOVËS | | |
| ADRESA | Gjakovë, Rr Nënë Tereza | | |
| TITULLI I KONTRATËS: | DEZINFETIMI, DEZINSEKTIMI DHE DERATIZIMI | | |
| NUMRI I IDENTIFIKIMIT PROKURIMIT | 632-25-2180-2-2-1 Nr i brendeshem 632-25-030-221 | | |
| LLOJI I SIGURIMIT GARANCISË | SIGURIMI I GARACIONIT TË KONTRATËS / PERFORMANCE BOND INSURANCE | | |
| ÇERTIFIKATA E GARANCISË DHE KJO POLICE SIGURIMI VËRTETOJNË LIDHJEN E KONTRATËS, DHE LËSHOHEN NGA SIGURUESI NË BAZË TË DEKLARIMEVE DHE KERKESAVE TË BËRA NGA PËRFAQËSUESI I TË SIGURUARIT, I CILI ëSHTë PËRGJEGJËS LIDHUR ME SAKTËSINË DHE VËRTETËSINË E DEKLARIMEVE TË BËRA PREJ TIJ | | | |
| UNË PERFAQËSUESI I TË SIGURUARIT, PASI I LEXOVA ME VËMENDJE DHE I KUPTOVA KUSHTET E KONTRATËS SË SIGURIMIT, DEKLAROJ SE PAJTOHEM ME TO, SI DHE ME TË DHËNAT DHE PËRCAKTIMET E ÇERTIFIKATËS SË GARANCISË DHE TË KËSAJ POLICE SIGURIMI, DHE PO NËNSHKRUAJ KONFORM VULLNETIT TIM TË LIRE, E TË PLOTË | | | |
| SIGURUESI |  Kompania e Sigurimeve "Eurosig" sh.a. DREJTORIA | I SIGURUARI |  N.U.I. 811498957 Prishtinë |

Për: KOMUNA E GJAKOVËS
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., Mehmet Akif Ersoy, Nr.17 Taslixhe , II, Prishtinë
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: DEZINFEKTIMI, DEZINSEKTIMI DHE DERATIZIMI

Numri i prokurimit: 632-25-2180-2-2-1 Nr i brendeshem 632-25-030-221

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Garacion

Nr.Serik i polices: 248/25

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;
DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit;
DHE NGASE NE jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë-nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **4,333.00** (katër mijë e tre qind e tridhjetë e tre Euro) zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha përmbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **4,333.00 Euro** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri është e vlefshme 396 ditë prej 10.07.2025 deri më 09.08.2026



Data: 10.07.2025

PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

| MBAJTËSI I LLOGARISË | |
|----------------------|-----------------------------------------------------|
| Name | |
| Emri | Doctor Exterminator DDD SH.P.K. |
| Adresa | Rr. Mehmet Akif Ersoy Nr.17 – Taslixhe II |
| Qyteti | Prishtinë |
| Kodi Postar | 10000 |
| Kontakti | Dr.Lulzim Katanolli |
| Telefoni | +383 44 158 638 / +383 48 158 638 |
| Faksi | |
| E-mail | info@doctorexterminator.com / drkatanolli@yahoo.com |
| Numri i TVSH | 330470758 / 811498957 |

| BANKA | |
|-------------------------|------------------------|
| Name | |
| Emri | NLB Banka SH.A |
| Adresa | Rr. Ukshin Heti nr.124 |
| Qyteti | Prishtinë |
| Kodi Postar | 10000 |
| Shteti | Kosovë |
| Llogaria Bankare | 1701017400373344 |
| IBAN (opcionale) | |
| BIC (Opcionale) | |

SHËNIME:

